



Autor: Jeton Mikullovi

VËSHTRIM

# 2016-shi, viti pas të cilit bota më kurrë nuk do të jetë e njëjtë, vërtet?

Një vit i ngjarjeve të paparashikueshme politike



Bodo Weber

Një seri e ngjarjeve madhore e ka shndërruar 2016-shin në një vit vërtet të veçantë, me ngjarjet që drodhën themelet e botës perëndimore: duke nisur nga kriza evropiane e refugjatëve, te vota britanike për Brexit-in, puçi i dështuar ushtarak në Turqi, rezultati i zgjedhjeve presidenciale amerikane e deri te sulmi terrorist në Berlin në prag të festës së Krishtlindjes. Dhe derisa politikëbërësit, analistët dhe publiku i gjerë kanë dalime të dukshme në vlerësimet e tyre për kuptimin dhe ndikimin e këtyre zhvillimeve, ata të gjithë pajtohen në një gjë – se është gjë e mirë që ky vit më në fund po përfundon.

Në të vërtetë, secila prej këtyre ngjarjeve e kanë shënuar në vete, të paktën potencialisht, një pikë

kthese politike. Kriza evropiane e refugjatëve nxiti kulminim e krizës së brendshme dhe strukturore të BE-së kur tentimet drejt bashkimit për veprim të 28 shteteve anëtare dështuan dhe kur receta politike e Unionit kundër krizës – leadershipi reaktiv gjerman i kombinuar me një koalicion të shteteve të vullnetshme anëtare – u përplasën për muri për të parën herë në më shumë se një dekadë. Vota e paramenduar për Brexit-in e nxori në pah një kombinim të dobësisë kronike të udhëheqjes në mesin e elitave politike dhe ngritjen e populizmit, jo vetëm në Britani, por edhe më gjerë në BE. Vendimi i pashembullt i një shteti të vjetër anëtar për të dalë nga BE-ja, la të kuptohet për herë të parë se ekziston mundësia për një shpërbërje të ardhshme të Unionit.

Në Turqi, spastrimet politike pas puçit të dështuar e vënë shtetin në shtegun që çon drejt diktaturës presidenciale dhe daljes nga orbita politike evropiane dhe perëndimore. Në SHBA, Donald Trump papritmas fitoi zgjedhjet presidenciale falë afrimit populist që refuzonte establishmentin politik dhe i sfidonte faktikisht të gjitha rregullat e shkruara dhe ato të pashkru-

ara të lojës politike. Politikën e tij të ardhshme, të shpallura publikisht, nëse zbatohen, do të nënkuptonin një moment vendimtar për SHBA-në dhe rendin global. Në kuadër të politikave ekonomike dhe tregtare ai paralajmëroi kthimin në sektorin e parregulluar financiar dhe orientimin drejt një politike tregtare të shënuar nga proteksionizmi kombëtar që si synim ka luftimin e forcave të globalizimit. Për sa u përket politikave ndërkombëtare, Trump paralajmëroi tërheqjen në një pozitë izolacioniste të papraktikuar qysh prej Luftës së Dytë Botërore. Derisa Trump synon të forcojë arsenalin e armëve bërthamore të SHBA-së, ai në të njëjtën kohë dëshiron të arrijë marrëveshje me burrështetas autoritarë si puna e Vladimir Putin. Kjo gjë do të shënonte një ndryshim të madh prej përkushtimit për aleanca tradicionale dhe leadership amerikan në ruajtjen e rendit liberal botëror, i cili do të çonte drejt një afrimi transaksional ndaj politikave të jashtme dhe të sigurisë dhe një lloj ringjalljeje multipolare të gjeopolitikave të sferës së ndikimit, të kohës së luftës së ftohtë. Me sulmin terrorist në Berlin,

dhuna islamike, më në fund, e goditi kryeqytetin e përfaqësuesit të fundit madhor perëndimor që i ruan vlerat liberale përkundër frymës në rritje të populizmit. Incidenti ka ngjallur frikën për zbrapsjen e liberale nën presionin e dyfishtë të ekstremizmit ndërkombëtar dhe nacionalizmit e racizmit të brendshëm në rritje.

## Vala e pesimizmit liberal

Në kombinim, këto ngjarje i dhanë shtysë një vale të pesimizmit liberal në Perëndim dhe përtej.

“Asgjë më nuk do të jetë e njëjtë”, ishte ndjenja që shoqëroi jo vetëm rezultatit e zgjedhjeve presidenciale në SHBA. Një numër gjithnjë më i madh i analistëve parashikojnë shpërbërjen e BE-së, fundin e ekspansionizmit amerikan dhe atë të rendit liberal që i dha formë botës gjatë 70 vjetëve të fundit. Megjithatë, përtej dorëzimit mazohist karshi këtij pesimizmi liberal, kur shikohet më nga afër e ardhmja e botës më 2017 duket të jetë më pak e qartë dhe më pak e zymtë. Për sa i përket BE-së, me fitoren e befasishme të Francois Fillon në zgjedhjet paraprake të

Partisë Republikane, Evropa sipas të gjitha gjasave do të kursehet nga të pasurit për president francez LePenin. Zgjedhjet e ardhme në Francë, Holandë dhe Gjermani do t'u sjellin përfitime të reja populistëve, por kjo nuk do të përbëjë një moment vendimtar. Kriza e BE-së prandaj ende ka gjasa që të shkojë në dy drejtime – mund ende të shërbejë si një thirrje për zgjim me qëllim të përafritimit kah reformat vërtet strukturore. Pozita e dobësuar e liderit të Gjermanisë mund megjithatë të mos rezultojë me fundin e leadershipit gjerman, por me krijimin e një stili ndryshe të udhëheqjes, një udhëheqje më integruese, më e orientuar kah dialogu. Për sa i përket vetë Gjermanisë, zgjedhjet e ardhshme parlamentare aty sipas të gjitha gjasave do të rezultojnë me mbi-jetesën e kancelares Merkel, edhe pse të dobësuar, dhe me një tërheqje vetëm të pjesshme nga pozita liberale, por jo edhe me braktisjen e përgjithshme të parimit të mbrojtjes së vlerave liberale.

Ndërkaq për Brexit-in, liderët britanikë dhe ata të BE-së do të pushojnë së shkëmbyeri fyerje ngase do të fillojnë t'i definojnë

OPINION

# E shkuara, jo si histori

**Në Shqipërinë e pasvitit 1990, nga dëshira për të vrapuar drejt asaj që na kishte munguar, u praktikua ajo që Bauman e quan “vetëshfajësim historik”, gjë që ka çuar një pjesë të shoqërisë në mosdashje për të dëgjuar çfarë ka ndodhur realisht gjatë diktaturës, duke e lënë të keqen të brehtë lirisht rreth nesh**

Agim Baçi

Në këta 25 vjet shpesh historia e së shkuarës komuniste është tentuar të shihet si një pikturë, sikur gjithçka ka ndaluar vetëm në një kohë të shkuar pa pasur asnjë lidhje me të sotmen. Sociologu Zygmunt Bauman, në librin e tij “Holokausti dhe moderniteti”, shpreh shqetësim lidhur me atë çfarë ka ndodhur me holokaustin, të cilin bota moderne ka dashur ta shohë vetëm si një të shkuar, si një çast çmendurie, sikur i përket vetëm një segmenti shoqëror. Por në fakt, a mund ta shohim të shkuarën vetëm si fragment, si një lajthitje çasti që mbetet vetëm në një çast të historisë?

Në Shqipërinë e pasvitit 1990, nga dëshira për të vrapuar drejt asaj që na kishte munguar, u praktikua ajo që Bauman e quan “vetëshfajësim historik”, gjë që ka çuar një pjesë të shoqërisë në mosdashje për të dëgjuar çfarë ka ndodhur realisht gjatë diktaturës, duke e lënë të keqen të brehtë lirisht rreth nesh. Si pasojë e këtij “vetëshfajësimi” është krijuar, në jo pak raste, ideja sikur debati mbi të shkuarën është thjesht një çështje historie dhe se u përket studiuesve të historisë apo politologjisë.

Pasojat e kësaj sjelljeje në Shqipëri i kanë vuajtur jo vetëm ish-të burgosurit politikë dhe ish-pronarët, të cilët në shumë raste kanë mbetur ende viktimat, pa rehabilitim e duhur që shoqëria u kishte borxh. Mjafton të shohim

sjelljen e qeverive të pasvitit 1991 në Shqipëri, të mbështetura mbi sloganin “bashkëfajtor-bashkëvuajtës”, për të kuptuar se ne si shoqëri e kemi parë të shkuarën si një pikturë, madje pa shumë ngjyra. Dhe, a nuk janë rezultatet e sondazhit më të fundit mbi nostalgjinë komuniste pasojë e vështrimit të së shkuarës si pikturë, si një gjë e stopuar?

Por në fakt, sa mund të mbijetojë me këtë model debati mbi të shkuarën? Sociologët që janë marrë me studimet e krimeve, duke iu referuar nazizmit, fashizmit, e sidomos regjimeve totalitare që shfarosën miliona qytetarë, kryesisht të pafajshëm, shprehen se, nëse nuk e shohim atë të shkuar si tentativë të përherëshme të së keqes për të përmbysur vlerat shoqërore, atëherë do të jemi nën rrezikun e asaj të keqeje vazhdimisht.

E për aq kohë sa nuk do të tentojmë të lexojmë si duhet të keqen e ndodhur, ne, edhe pse do të vijojmë të shprehim keqardhje për ata që u shfarosën apo vdiqën në burgje dhe kampe internimi, edhe pse do të kemi ditën e kujtesës për ato krime, edhe pse do të mbajmë fjalime prekëse për ata që u torturuan dhe u syrgjynosën, sërish ne nuk do të mund të nxjerrim të keqen që ka bërë fole në kokat tona. Për aq kohë sa nuk e mendojmë si pjesë tonën atë të keqe, nuk do të mundet dot ta zbojmë, por thjesht do të shtojmë nihilizmin tonë ndaj asaj të shkuarë,

e cila tashmë është rikthyer thuasht fitimtare.

Ne, p.sh., si shoqëri, ende nuk kemi mundur të kthejmë ndonjë përgjigje për pyetje si ato të politologut dhe filozofit francez, Chanta Millon-Delsol, i cili në librin e tij “Idetë politike në shekullin XX” pyet se cila ishte ajo forcë që bëri bashkë inteligjencën e vendeve ish-komuniste, madje edhe elitën në mjaft shtete perëndimore, për të mbështetur apo simpatizuar regjimet totalitare, kriminale, që shfarosën miliona të pafajshëm? Një lloj përgjigjeje e jep nobelisti polak, Çesllav Milosh, në librin e tij “Mendja e robëruar”, kur shprehet se “është dëshira jonë e brendshme për të mos besuar se njeriu mund të arrijë në krime aq të tmerrshme”.

Pastaj, ai sheh si një problem të jashtëzakonshëm kalimin nga censura në atë që e konsideron kryerrezikun e shoqërive Auto-censurën. Dhe, a nuk rrezikohemi ne çdo ditë nga autocensura? A nuk jemi në për shkak të kësaj marrëdhënieje të dyzuar në kërkimin e së vërtetës për të shkuarën dhe të tashmen? A nuk provojmë ne heshtjen në vend të gjetjes së fjalës së duhur përballë padrejtësive që na duken të padëmshme dhe të vogla? Shkrimtari hebre nga Serbia, Filip David, në romanin e tij “Shtëpia e harresës dhe kujtesës”, shprehet se shpesh “fara e së keqes fshihet pas harresës”, ose më saktë “pas

absurditetit të harresës”.

Ai shprehet se “brezat tentojnë ta rishkruajnë historinë çdo 40 vjet, duke tentuar të mos kenë dëshmitarët e së shkuarës nëpër këmbë. Kështu, humanizojnë të keqen në të shkuarën dhe kërkojnë të kontrollojnë të ardhmen”. Sociologu Zygmunt Bauman, politologu Milon-Delsol, poeti dhe filozofi Çesllav Milosh apo kriminologu i madh norvegjez, Nils Christie, ngrënë si alarm për shoqëritë pikërisht rutinizimin e së keqes, burokratizimin e kriminit dhe sidomos neutralizimin e qëndrimeve etike të shoqërisë ndaj së keqes. Është pikërisht kjo e fundit që rrezikon çdo shoqëri, sidomos shoqëritë që nuk kanë guxuar të lexojnë të shkuarën kriminale si një e keqe që fle mes nesh edhe kur ke arritur ta lexosh mirë atë.

Ndërsa nëse nuk ke guxuar të shohësh brenda njeriut, bashkëpunimin e elitave, justifikimin në emër të idealeve, atëherë rreziku është edhe më i madh, duke u kthyer në atë që parajmëronet Hanah Arendt në “përgjegjësinë e askujt”. Deri më sot shoqëria shqiptare ka jetuar me “krimet e askujt”. Për pasojë, sondazhi mund të jetë edhe më katastrofik pas një apo dy vjetësh, nëse xhelatët, persekutorët do të vijojnë të jenë pjesë e nderuar e historisë, apo do të vijojnë të na flasin për “ndershmërinë e tyre në zbatimin e ligjit”.

(Panorama)

marrëdhëniet e tyre të ardhshme. Për Britaninë, ky në të njëjtën kohë do të jetë momenti i kapërcimit prej një populizmi pa kosto drejt një kontrollimi të matur të realitetit. Shtegu i Turqisë duket se do të shpjerë pashmangshëm drejt krijimit të një diktature presidenciale nën Erdoganin, mirëpo realizimi i transformimit autoritar të pushtetit tek AKP-ja njëkohësisht do të kërcënohet nga rrezikimi i prosperitetit ekonomik dhe paqes së brendshme. E për sa i përket Amerikës së Trumpit, ajo që pritet të shihet pas 20 janarit të vitit 2017 është një përplasje serioze ndërmjet një lëvizjeje politike në ardhje të papërvujtë, e anti-establishment në njërën anë dhe establishmentit dhe institucioneve të shtetit në anën tjetër.

Lidhur me politikën e ardhshme ndërkombëtare të administratës Trump, çdo synim për të ringjallur një lloj Luftë të Ftohtë të shekullit 21 me ringjalljen e gjeopolitikave do të hasë në telashe qysh në fillim – së pari, për shkak se Trump do të mësojë se autokratët si Putin kanë pak çka për ofruar për politikën e jashtme transaksionale dhe të sigurisë, dhe së dyti, për shkak të dobësisë së qenësishme dhe paafësisë së këtyre regjimeve autokrate (si në Rusi, Turqi, e madje Kinë) si dhe mungesës së një ideologjie që ata mund t’u ofrojnë satelitëve potencialë në sferën e tyre të ndikimit. Me t’i marrë të gjitha këto bashkë, një periudhë e çorientimit të politikave të jashtme dhe të sigurisë dhe e jostabilitetit duket si skenari më i mundshëm për performancën e administratës së ardhshme Trump.

Për sa u përket politikave të Perëndimit si tërësi, kjo gjë sipas të gjitha gjasave do të nënkuptojë se ne do të shohim një vazhdimësi të politikës ekzistuese profetike, vetëpërbushëse të dobësisit të

rendit liberal – të dobësisit të rendit liberal shkak i përqendrimit të BE-së dhe SHBA-së në vajtimin e pushtetit global në tkurrje, në vend të trajtimit me seriozitet të krizave të ndryshme të brendshme strukturore. Kjo politikë përfshin mohimin e gjasave për përhapjen e mëturjeshme globale të demokracisë dhe si rrjedhojë injorimin e interesave të shprehura dhe nevojave për demokratizim të mëturjeshëm përtej Perëndimit tradicional (në botën arabe, në Ukrainë, Ballkanin Perëndimor etj.).

Çfarë do të thotë kjo për Ballkanin Perëndimor dhe për Kosovën? Kjo gjë në rend të parë do të thotë se ne me shumë gjasë nuk do të shohim ndonjë ndryshim fondamental në rajon gjatë 2017-s. Në anën tjetër, në njëkohësisht mund po ashtu të mos shohim ndonjë përmirësim të qenësishëm të gjendjes politike në Ballkanin Perëndimor. Politikën e jashtme amerikane padyshim se nuk do të përqendrohen në Evropë, e lëre më në Ballkanin Perëndimor apo në Kosovë. Sidoqoftë, kjo nënkupton se nuk do të ketë ndryshime qenësore nga ajo që tanimë kemi pasur gjatë administratës Obama.

Në praktikë, kjo mund të nënkuptojë se Departamenti amerikan i Shtetit do të mbetet i angazhuar në rajon dhe në Kosovë, bazuar më shumë në trashëgiminë e ish-rolit prijës perëndimor të SHBA-së në rajon se sa në ndonjë mbështetje serioze prej kreut të tij. Britania do të mbetet e angazhuar në politikën e zgjerimit dhe në zgjidhjen e konflikteve për status të pagzjidhura në Ballkan si një prej shteteve anëtare më proaktive të BE-së, mirëpo me ndikim në venitje – një qëndrim ky vetëm gradualisht por jo edhe fundamentalisht i ndryshëm prej atij të para vendimit për Brexit. Për sa u për-

ket politikave të BE-së karshi Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, politika e zgjerimit do të vazhdojë të jetë e zënë ngushtë, sikurse edhe më parë, ndërmjet preokupimit të tepër të Unionit me vetveten dhe pranimit në heshtje të kërcënimit potencial të sigurisë që rajoni do të përbëjë për Evropën në rast të shpërbërjes së BE-së apo përfundimit të procesit të zgjerimit. Gjermania do ta ruajë rolin e vet prijës, vetëm për shkak të mungesës së angazhimit serioz të ndonjërit prej shteteve më të fuqishme anëtare.

Dhe çfarë do të thotë kjo për performancën e ardhshme të shteteve të Ballkanit Perëndimor, të Kosovës?

Sipas të gjitha gjasave kjo nuk do të nënkuptojë ndonjë ndryshim radikal në orientimin e BE-së për shtetet e rajonit, përfshirë Serbinë. Megjithatë në Serbi, si dhe në shumicën e pjesëve të banuara me serbë të shteteve të tjera, joshja nga ndjenjat dhe retorika nacionaliste proruse padyshim se do të rritet, siç do të rriten edhe apetitet ruse për përzierje në çështjet lokale, për të luajtur rol ndërhyrës me qëllim të dobësisit të ndikimit të BE-së në rajon dhe për ta destabilizuar Unionin nga periferia.

Sidoqoftë, ajo që nuk do të zhduket është vetëdija në mesin e vendimmarrësve të brendshëm dhe grupeve të tjera të rëndësishme sociale se Rusia nuk ofron një alternativë reale për integrimin në BE.

Megjithatë, do të jetë më e zorshme, si për elitat politike ashtu edhe për forcat sociale proeuropiane në Ballkanin Perëndimor, që të argumentojnë në favor të një perspektive evropiane. Kjo, po ashtu, është një situatë aspak më ndryshe prej viteve të fundit, në të cilën mbështetja për BE-në në mesin e

qytetarëve të periferisë tanimë ka qenë gradualisht më e lartë se në mesin e qytetarëve të shumë shteteve anëtare.

Sido që të jetë, vetë fakti se orientimi pro-BE i elitave politike në rajon ka qenë më i motivuar nga konformizmi se sa nga bindja e sinqertë, mund ta bëjë më të vështirë mbrojtjen e këtij orientimi politik, tani që BE-ja po bëhet më pak joshëse. Kjo gjë mund të rrisë apetitet e elitave për ta shtyrë BE-në e dobësuar drejt kompromiseve të mëturjeshme për kushtëzimin e reformës së saj demokratike. Në mënyrë alternative, askush nuk mund ta hedhë poshtë plotësisht mundësinë që ndërgjegjësimi për një Bashkim Evropian në krizë serioze dhe pa një alternativë reale për të ardhmen do të hapë rrugën për kthimin e elitave rajonale politike drejt një shtyese serioze për reforma strukturore.

Në fund, çfarë sinqerisht nënkupton e gjithë kjo për forcat liberale pro-evropiane, pro-perëndimore në shtetet e Ballkanit Perëndimor? Roli i tyre në terrenin e brendshëm do të jetë më i rëndësishëm se kurrë më parë. Mirëpo në të njëjtën kohë do të bëhet gjithnjë e më e rëndësishme që zëri i tyre të fillojë të dëgjohet në Perëndim, që t’i bashkohen luftës në mbrojtje të Perëndimit liberal dhe rendit liberal ndërkombëtar, duke argumentuar se me qëllim të mbijetesës së që të dyjave nuk do të nevojitet vetëm kapërcimi i problemeve strukturore të BE-së dhe SHBA-së, por edhe demokratizimi i mëturjeshëm përtej Perëndimit tradicional.

(Bodo Weber është analist politik në Berlin dhe një anëtar i lartë i Këshillit për Politikën të Demokratizimit (DPC). Analiza është shkruar ekskluzivisht për “Kohën Ditore”).

# KOHA DITORE

E përditshme e pavarur informative

Themelues: Veton SURROI  
Numri i parë u botua më 31 mars 1997

Pronare dhe botuese:  
Flaka SURROI

Gazeta redaktohet nga kolegji i:  
Kryeredaktor: Agron BAJRAMI  
Zv. kryeredaktore: Valbona MEHMETI  
Redaktore: Brikenda REXHEPI  
Redaktor: Elmaz ISUFI

Zenun ÇELAJ (Portali),  
Bekim KUPINA (Kosovë),  
Visar LOCI (Sport),  
Granit KURTI (Kulturë),  
Nita LLESHI & Arbana MJEKIQI (Botë),  
Sami KÇIKU (Mes për Mes),  
Ben KAJTAZI (Qendra Grafike),  
Alban BUJARI & Driton PAÇARADA (Fotografi)

Telefonat e redaksisë:  
038/249-104  
249-105; 243 875  
Fax: 038/249-106

Fahu postar 202  
e-mail: redaksia@kohaditore.com  
Marketing: tel & fax: 038/248-880  
e-mail: marketing@kohaditore.com  
marketing@koha.net

Xhironlogaria:  
ProCredit - 1110086926000189  
NLB - 1701001010645930  
TEB - 2011000000081423  
Raiffeisen - 1501001002095874  
BKT - 1901217632031247  
B. Ekonomike - 1401000000903831  
BpB - 13002712000030870

Shtypet në Shtypshkronjën “KOHA”  
tel. 044/126 367

Marketingu për botimin ndërkombëtar:  
Koha Ditore  
Era Press GmbH  
Sihlstrasse 38  
CH-8001 Zürich

Tel.+41(0) 43 497 32 80  
koha@erapress.ch

Konto në Zvicër:  
Credit Suisse  
Konto: 992472-01-2  
IBAN: CH85 0483 5099 2472 0100 2  
BIC/SWIFT: CRESCHZZ80A

Druck:  
SM Druckhaus GmbH  
D-633303 Dreieich

Nuk lejohet ribotimi i pjesëshëm apo i plotë, në cilindo medium, i cilitdo material për të cilin KOHA Ditore i mban të drejtat e rezervuara, pa autorizimin paraprak me shkrim nga KOHA Ditore

Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen

Rubrika e përhershme “Shprehu” është krijuar si hapësirë e “Kohës ditore” për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve. Të gjitha shkrimet nuk duhet të jenë më të gjata se 500 fjalë. Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës. Opinionet e shprehura në këtë rubrikë nuk përfaqësojnë qëndrimet e redaksisë.